



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 95/1 Prot

Tiranë, më 16/12/2021

VENDIM

Nr. 04, datë 16.12.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. Edmond Hoxhaj, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1646 Prot., datë 23.12.2020, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet shkresës datë 11.11.2020, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni, si më poshtë:

1. *Lista e pasurive të referuara në Prokurori për sekuestro preventive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale për vitet 2010 - 2020, e ndarë sipas viteve dhe e specifikuar me llojin e pasurive, vlerën e përlogaritur të tyre dhe personat që e dispononin atë në momentin e hetimit/referimit.*
2. *Lista e pasurive të referuara në Prokurori në vitet 2010 - 2020 për vendosjen e sekuestros, të identifikuara nga Policia e Shtetit, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". (Ligji Antimafia), e ndarë sipas viteve dhe e specifikuar me llojin e pasurive, vlerën*

e përlogaritur të tyre dhe personat që e dispononin atë në momentin e hetimit/referimit.

3. Lista e pasurive të identifikuara nga Policia e Shtetit dhe të referuara në Prokurori në përputhje me Aktin Normativ nr. 01, datë 31.01.2020, miratuar me ligjin nr. 18/2010, datë 05.03.2020.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik (në vijim "Koordinatori"), nëpërmjet e-mail-it datë 12.11.2020, ka njoftuar se për shkak të pamundësisë fizike, si pasojë e pandemisë Covid 19, të dhënat e detajuara mund të merren në Prokurori në rast se lejohet.

Në vijim, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1646/1 prot., datë 28.12.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet në lidhje me trajtimin apo procedurën e ndjekur në lidhje me kërkesën për informacion.

Koordinatori nëpërmjet e-mail-it, ka vendosur në dispozicion pjesërisht informacionin në mënyrë statistikore.

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, ka vijuar me ankimin nr. 95 Prot., datë 14.01.2021, duke pretenduar se kjo përgjigje nuk i përgjigjet kërkesave të paraqitura.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: "*Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", si dhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar si pasojë e përhapjes së COVID-19 dhe në zbatim të masave të marra nga institucionet përkatëse, seanca dëgjimore u zhvillua nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (on-line/video-call), në datën 25.01.2021, ora 10.00 me prezencën e palëve.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar më sipër.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesit të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur.

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 02.02.2021, ankuesi ka vijuar me ankimin duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit të plotë.

Koordinatori, me e-mail-in datë 04.02.2021 ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: *"...personi përgjegjës që merret me të dhënat e kërkuara është karantinuar për shkak të kontaminimit nga COVID 19. Në këto kushte kërkon kohë deri në rikthimin në detyrë të personit përgjegjës, për të nxjerrë të dhënat e disponuara për pjesën e pasurive të sekuestruara për të cilat ka përfunduar procesi gjyqësor, pasi të dhënat e tjera nuk disponohen..."*.

Komisioneri, megjithëse ka mirëkuptuar vështirësitë e hasura për shkak të problematikave të krijuara nga pandemia COVID 19, për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor, nuk përfundon në asnjë moment Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Në nenin 15 të LDI "Afati për marrjen e informacionit" parashikohet se:

"1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.....

3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c)...

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.

4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji."

Për rrjedhojë, pavarësisht vështirësive të hasura si pasojë e volumit të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, si dhe situatës së pandemisë COVID-19, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik ka patur në dispozicion kohën e nevojshme për të trajtuar kërkesën e paraqitur nga Ankuesi.

Bazuar në sa më sipër, pas konsultimit të legjisllacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në parim përbën

informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Në këto kushte, informacioni i zotëruar nga Autoriteti Publik, i duhet vënë në dispozicion kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, si dhe në respektim të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrotjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

Në këto argumente ligjorë, nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar pjesa tjetër nuk i refuzohet ankuesit. Autoriteti Publik duhet të bëjë anonimizimin e të dhënave në përputhje me nenet e sipërcituara.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1646 Prot., datë 23.12.2020 të z. Edmond Hoxhaj, kundër Autoritetit Publik *“Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”*, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 11.11.2020, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, si dhe në respektim të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrotjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, konkretisht: (1. *Lista e pasurive të referuara në Prokurori për sekuestro preventive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale për vitet 2010 - 2020, e ndarë sipas viteve dhe e specifikuar me llojin e pasurive, vlerën e përlllogaritur të tyre dhe personat që e dispononin atë në momentin e hetimit/referimit.* 2. *Lista e pasurive të referuara në Prokurori në vitet 2010 - 2020 për vendosjen e sekuestros, të identifikuar nga Policia e Shtetit, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit,*

korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". (Ligji Antimafia), e ndarë sipas viteve dhe e specifikuar me llojin e pasurive, vlerën e përlogaritur të tyre dhe personat që e dispononin atë në momentin e hetimit/referimit. 3. Lista e pasurive të identifikuar nga Policia e Shtetit dhe të referuara në Prokurori në përputhje me Aktin Normativ nr. 01, datë 31.01.2020, miratuar me ligjin nr. 18/2010, datë 05.03.2020), brenda datës 23. 2.2021.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 16. 2.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



